



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

OPINION MBI KANDIDATIN ZNJ. DANIELA SULAJ (KONICA)

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 pika 2, 54 dhe 55 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 05.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

- ***Inspektor pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.***

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim u përcaktua 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë paraqiten kërkesë 6 (gjashtë) prokurorë.

Në datë 19.02.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë u protokollua kërkesa e prokurores Daniela Sulaj (Konica), e cila aktualisht ushtron funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54 pika 4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës duhet të përgatisë një projekt-opinion për çdo kandidat dhe të vlerësojë nëse komandimi është apo jo në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar çënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezultoi se:

- Prokurorja Daniela Sulaj (Konica) ushtron funksionin e magjistratit që prej vitit 2004, pasi me dekretin nr. 4347, datë 11.10.202004 të Presidentit të Republikës, është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavaë. Nga dosja personale rezulton se është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë dhe është transferuar si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ku ushtron aktualisht funksionin. Znj. Daniela Sulaj ka një eksperiencë profesionale në punë si prokuror rreth 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Në këto kushte për këtë prokurore nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me kriterin e cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë, rezultoi se:

- Nga kthim-përgjigja nr.2642/1 datë 21.02.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë rezulton se KLP-së i është bërë me dije ngarkesa aktuale dhe ajo gjatë vitit 2019 i të tre kandidaturave në një kuadër të përgjithshëm, ku trajtohet përveç ngarkesës së tyre edhe problematikat e ardhura nga largimet e prokurorëve të kësaj prokurorie. Në fund të kësaj shkrese Drejtuesja e lë në dorë të Këshillit gjetjen e modaliteteve për komandimin ose jo të tyre duke mos cënuar punën e prokurorisë në kushtet aktuale

Në këto kushte, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i znj. Daniela Sulaj (Konica) si Inspektor pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk passjell cënim të interesit më të lartë të Prokurorisë Tiranë si dhe nuk cenohet funksionaliteti i saj. Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se ngritja dhe funksionimi i ILD, është prioritar. Vëme theksin gjithashtu se aktualisht Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka filluar edhe procedurën e plotësimit të vendeve vakante në këtë zyrë prokurorie nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele të prokurorëve.

Në zbatim të nenit 55 pika 2 të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me Vendimin nr.55, datë 24.02.2020 nisi procedurat për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës të magjistratëve kandidatë për t’u komanduar si Inspektorë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në përmbyllje të procedurës së verifikimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me Vendimin nr.12, datë 14.01.2021, ka vendosur të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidates si dhe lejimin e saj për vijimin e procedurës së komandimit si Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës duke konsideruar të përmbushura të gjitha fazat e procedurës së komandimit për pozicionin e inspektorit pranë Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Miratimin e opinionit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për kandidaten prokurore Daniela Sulaj (Konica).